



Datë: 17.03.2025

Numër Protokolli: 2514/2025

A.nr.176/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari, dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.176/2024, të datës 22.01.2025, të parashtruar nga ankuesi A.Th të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat Hajzer Salihu, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridiko-administrative “*masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi, 1 nën paragrafi, 1.1, nenin, 16 paragrafi, 3 dhe nenin, 18 paragrafi, 1 nën paragrafin, 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet pjesërisht si e bazuar** ankesa me numër A.nr.176/2025, e datës 22.01.2025 e parashtruar nga ankuesi A.Th, në atë mënyrë, që aprovohen pretendimet lidhur me shkelje materiale, ndërsa, refuzohen pretendimet për shkelje procedurale.
- II. **Anulohet** Vendimi me Nr.15/2024 i datës 24.12.2024, i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Shëndetësisë.
- III. **Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë për Burime Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi, ashtu që masën disiplinore të shfuqizuar si në pikën II të dispozitivit, ta largoj nga dosja personale e nëpunësit civil si dhe regjistrat përkatës.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për ndërmarrjen e veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil A.Th (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 22.01.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.15/2024 të datës 24.12.2024 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë, për shkak shkeljeve formale - procedurale ligjore dhe shkeljeve materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.01.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje

në ankesën e ankuesit tek Ministria e Shëndetësisë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 10.02.2025, ka përcjell provat lidhur më çështjen në procedurë, duke mos dhënë përgjigje në pretendimet ankimore të ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 459/2025 të datës 22.01.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.10/2024 të datës 24.12.2024 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë; Procesverbalin e datës 02.12.2024 të Komisionit Disiplinor; Vendimin e datës 03.12.2024 të Komisionit Disiplinor për shtyrje të afatit të përfundimit të procedurës; Kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore e datës 25.10.2024; Emailin e datës 07.11.2024 nga A.M për ankuesin; Emailin e datës 07.11.2024 nga ankuesi për A.M; Emailin e datës 24.10.2024 nga D.R për B.M; Emailin e datës 27.09.2024 nga B.M për ankuesin, B.B dhe E.U; Emailin e datës 01.11.2024 nga B. M për A.M; Emailin e datës 18.11.2024 nga A.M për B.M; Emailin e datës 01.10.2024 nga B.M për H.S; Emailin e datës 30.09.2024 nga H.S; Raporti i prezencës për punës për ankuesin prej datës 02.01.2024 deri më datë 02.12.2024; Akt Emërimit e datës 26.11.2013; Autorizimin e datës 15.01.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 31.01.2025; Përgjigjen në ankese datës 10.02.2025; Emailin e datës 27.11.2024 nga A.M për ankuesin; Procesverbalin e datës 17.12.2024 të Komisionit Disiplinor; Vendimin A.nr.268/2024 të KPMSHCK-së; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 30.01.2024; Emailin e datës 25.10.2024, 09.10.2024 nga N.B për B.M; Përshkrimin e detyrave të punës Zyrtar i lartë i Prokurimit; Emailin e datës 06.07.2024 nga B.M për ankuesin Kontrata për rregullimin e kontinjerave në MSH; Kontrata për furnizim me uniforma për ISSH dhe SHFAKM; Emailin e datës 20.06.2024 dhe 18.06.2024 nga B.M për ankuesin; Kontratës për shërbim “hartimi i objektit të marrur me qera nga AKP për Depo Qendrore të Barnave dhe Zyra të Farmacisë”; Emailin e datës 29.05.2023 nga B.M për ankuesin; Emailin e datës 26.05.2023 nga ankuesi për B.M; Raporti i vlerësimit të tenderëve datë 25.05.2023; Emailin e datës 29.09.2023 nga ankuesi për A.Th, B.B, E.U dhe E.Sh; Emailin e datës 29.09.2024 nga V.K; Emailin e datës 29.09.2023 nga N.B për B.M; Emailin e datës 07.07.2023 nga B.M për ankuesin; Vendimin e datës 03.03.2025 për shtyrje të afatit të vendosjes së ankesës së ankuesit.

Duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, Kolegji i Këshillit ka gjetur se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara, **sepse:**

Nga provat e lëndës del se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe së i njëjti sipas Aktit të Emërimit të datës 26.11.2013, mbanë pozitën e punës Zyrtar i Prokurimit, Divizioni i Prokurimit.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rrjedh se Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, më datë 25.10.2024, ka parashtruar kërkesë në Komisionin Disiplinor të MSH, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit, me arsyetimin se: ankuesi ka pasur sjellje të papranueshme në zyrë duke mbajtur këmbët mbi tavolinë, ka treguar nivel shumë të ulët të përkushtimit në punë; bënë lëvizje të shpeshta nga vendi i punës pa arsye dhe pa paralajmërim duke munguar pa informuar mbikëqyrësin e tij; komunikon me operator ekonomik dhe persona të jashtëm shpesh janë parë të shoqëruara me operator ekonomik jashtë zyrës, brenda dhe jashtë objektit të ministrisë.

Komisioni Disiplinor më Vendimin me Nr. 15/2024, të datës 24.12.2024, ka shpall ankuesin përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore sipas nenit 56 paragrafi 4.1, 4.2, 4.3, 4.6, 4.7, 4.11 dhe 4.20 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, duke i shqiptuar masën disiplinore “*Ulje në pozitë*”, duke kaluar nga klasa profesional 1, në klasën profesional 2.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit me Nr.15/2024 të datës 24.12.2024, të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë, pretendon se ky vendim është nxjerr me shkelje procedurale ashtu që vendimi i kontestuar është nxjerr jashtë afatit ligjor dhe se inicimi i procedurës disiplinore nuk është bërë nga udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankuesit. Tutje, shton se vendimi i kontestuar karakterizohet edhe me shkelje materiale, sepse, Komisioni Disiplinor nuk ka arsyetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe juridike, për faktin se nuk ka arritur të argumentoj mjaftueshëm përgjegjësinë disiplinore të ankuesit por vetëm duke mos dhënë asnjë arsyetim konkret pa fakte. Komisioni Disiplinor si rrethanë rënduese për ankuesin ka marr faktin se ankuesi ka pasur vërejte nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt më datë 27.09.2024, dhe nuk e ka kundërshtuar; Sa i përket përgjegjësisë për takim me operatorët ekonomik, ankuesi pretendon se ky konstatim nga ana e Komisionit Disiplinor është nxjerr pa pasur asnjë lloj prove konkrete e këtë e mbështet edhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejt përmes përgjigjes së datës 21.11.2024, ndërsa Komisioni Disiplinor vetëm e aprovon kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore. Lidhur me respektimin e orarit, Komisioni Disiplinor ka vendosur në mënyrë selektive ngase sipas emailit të datës 21.11.2024 dhe 27.09.2024 për të gjitha zyrtarët e divizionit, vijueshmëria të jetë në kohë dhe nga kjo kohë ankuesi nuk ka pasur asnjë vonesë. Kërkon që të aprovohet ankesa, të anulohet vendimi i kontestuar dhe të hiqet masa disiplinore nga dosja personale.

Në kuptim të vendosjes meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik përkitazi me rregullimin e procedurës dhe përgjegjësinë disiplinore të nëpunësve civil, gjegjësisht:

-Nenit 55: “1. Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim”.

- Nenit 56 : “1. Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. 2. Shkeljet e rënda të detyrave dhe përgjegjësi të punës janë të përcaktuara me ligj, ndërsa shkeljet e lehta janë të përcaktuara me ligj dhe rregulla të brendshme. 3. Shkelje të lehta konsiderohen: 3.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi; 3.2. mosrespektimi i orarit të punës; 3.3. sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun; 4. Shkelje të rënda konsiderohen: **4.1. mospërbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhencë e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil; 4.13. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja e/i dehur në punë; 4.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civil; 4.18. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore**

dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi”.

Në kuptim të kuadrit ligjor si më lartë, Kolegji ka analizuar aktin e kontestuar në ndërlidhje me provat materiale të lëndës dhe si rrjedhojë ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë pjesërisht të bazuare për arsye të:

-Lidhur me pretendimet për shkelje procedurale për shkak të tejkalimit të afatit ligjor për nxjerrje të vendimit dhe inicim të shkeljes disiplinore nga personi jo kompetent, Kolegji i Këshilli nga shqyrtimi i provave të lëndës erdhi në konstatimin se nuk gjejnë mbështetje këto pretendime, sepse, kërkesa për inicim disiplinor ndaj ankuesit është bërë më datë 25.10.2024, ashtu që, duke u bazuar në nenin 13 paragrafi 7 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil, afati për vendimmarrje është 45 ditë, që i bie se data e fundit e vendimmarrjes ka qenë 09.12.2024, mirëpo, Komisioni Disiplinor në mbështetje të nenit 98 dhe 99 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje LPPA) më datë 03.12.2024, ka marrë Vendim me numër protokolli 05-8302/2, për shtyrjen e afatit për përfundimin e procedurës disiplinore edhe për 15 ditë (kalendarike), e që dita fundit për vendimarrja ka qenë 24.12.2024, datë edhe në të cilën është nxjerr vendimi i kundërshtuar me ankesë. Rrjedhimisht, në këtë kontekst, Kolegji mori parasysh dispozitat e nenit 81 paragrafi 2 të LPPA-së ku parashihet se: 2. Kur afati përcaktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja nga e cila fillon të ecën afati. Ndërsa, lidhur me shkeljet procedurale përkitazi me faktin se inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit nuk është bërë nga udhëheqësi i tij i drejtpërdrejt, Kolegji duke u bazuar në përcaktimet ligjor sipas paragrafit 3 të nenit 59 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ri thekson faktin se Komisioni Disiplinor fillon procedurën me kërkesë të mbikëqyrës/it të drejtpërdrejtë të nëpunës/it civil; bazuar në të gjeturat dhe/apo rekomandimet e çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditimi, ose të çdo zyrtareje/i tjetër brenda institucionit, si dhe me kërkesën e qytetares/it; dhe me nismën e çdo anëtare/i të komisionit, mbi bazën e dyshimit të bazuar për kryerjen e një shkeljeje disiplinore, pra, Sekretari i Përgjithshëm i MSh është person kompetent për inicim të procedurës disiplinore në Komisionin Disiplinor dhe ndaj çdo nëpunësi civil kur supozohet për shkelje të rënda disiplinore, pasi që i njëjti është zyrtar me i lart administrativ i institucionit përkatës e kompetenca të kontrollit administrativ.

-Ndërsa, në kuptim të shkeljeve materiale, Kolegji nga vlerësimi i shkresave të lëndëve ka konstatuar se Komisioni Disiplinor nuk vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe nuk ka arritur të argumentoj përgjegjësinë e disiplinore të ankuesit lidhur me shkeljet që i janë ven në barrë. Rrjedhimisht, lidhur me shkeljen për sjelle të papranueshme të ankuesit pasi që i njëjti në prani të udhëheqësit, auditorit të brendshëm dhe prezencën e Sekretarit të Përgjithshëm vendos këmbët në tavolinë në vendin dhe orarin e punës, Kolegji si provë ju referua emalit të datës 07.09.2024 të Zyrtarit A.M, i cili në ditën ku i referohet shkelja ka qenë prezent, me ç ‘rast deklaroi se citojmë: *dëshiroj të theksoj se gjatë kohës së qëndrimit tim në zyrën tuaj nuk kam qenë dëshmitar i asnjë ngjarjeje të tillë dhe nuk kam vërejtur asnjëherë sjelle të këtij lloji.* Ndërsa, Zyrtari D.R, në pozitën e Udhëheqësit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, në deklaratën tij të datës 24.10.2024, ka sqaruar nder të tjera: *... Sidoqoftë, në lidhje me përmendjen time si dëshmitar ne rast kur është pretenduar se koleget kanë mbajtur këmbët mbi tavolinë gjatë orarit të punës, dua të theksoj se nuk me kujtohet ndonjë situatë e tillë të ketë ndodhur në praninë time.*”. Deklarata këto që Komisioni Disiplinor fare nuk i kishte trajtuar, por të njëjtat janë shmangur si prova dhe për tepër Komisioni Disiplinor nuk i ka ftuar të njëjtë që ti dëgjoj në cilësi të dëshmitarit për vërtetim të pretendimeve të iniciuesit të kërkesës.

Rrjedhimisht, përkundër faktit që më asnjë provë nuk vërtetohet se ankuesi gjata orarit dhe në vendin e punës ka vendos këmbët në tavolinë, në vlerësimin e Kolegjit veprimet e tilla edhe po të provoheshin si të ndodhura, atëherë, si të tilla nuk përbejnë shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 56 paragrafët 4.6

dhe 4.7 të Ligjit për Zyrtarët Publik (*shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; dhe sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil*) por si veprime dhe sjellje jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun (*neni 56.paragrafi 3.3*).

Përkitazi më shkeljen disiplinore se ankuesi ka pasur takim me operatorët ekonomik, jashtë zyrës së punës, edhe pse brenda objektit dhe në hapësirat e jashtme të ministrisë, Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave të çështjes nuk ka arritur të vërtetoj këtë qëndrim, sepse, nga organi i punësimit nuk është prezantuar asnjë dëshmi relevante dhe bindëse që vërteton se ankuesit edhe më parë i ishte tërhequr vërejtje për një shkelje të tillë, për me tepër, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit përmes emailit të datës 21.11.2024 në përgjigje të kërkesës së Zyrtares së Lartë të Burimeve Njerëzore, thekson se: *shprehjen tuaj kontakti me operator ekonomik jashtë raporteve zyrtare unë nuk e kam cekur në emailin e datës 01.10.2024, andaj ju lutem ta korrigjoni ne dokumentet e juaja, meqenëse mund të marr konotacion tjetër për çka unë nuk e kam shkruar e as që e kam për qëllim... duhet të sqaroj se potencimi :shpesh here te shoqëruar me OE, jashtë vendit të punës ka te bëjë më korridoret e objektit apo para objektit te MSH, ndersh nuk ka te bëjë jashtë MSH-së* “ provë kjo që po ashtu fare nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni Disiplinor me rastin e vendosjes lidhur me çështjen disiplinor të ankuesit.

Sa i përket konstatimit për shkelje disiplinore lidhur me mos respektimin e orarit të punës, Kolegji nga analizimi i Raportit të Vijueshmërisë në Punë lidhur me ankuesin për vitin 2024 si dhe provave tjera të lëndes ka gjetur se është fakt i pakontestueshëm se ankuesi nuk ka mungesa te paarsyetuar në punë dhe së i njëjti për periudhën janar-shtator 2024, ka regjistrim te vijueshmërisë në punë jo të rregullt, mirëpo asnjëherë i njëjti nuk ka pranuar vërejtje qofte nga Njësia e Personalit apo nga Mbikëqyrësi lidhur me këtë fakt. Rrjedhimisht, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit më datë 27.09.2024, përmes emailit me titull “kërkesë”, kërkon nga stafi i Divizionit të Prokurimit që nga e hëna datë 30.09.2024, vijueshmëria të jetë në kohë, e nëse marrin parasysh raportin e vijueshmërisë në punë konstatohet se nga 30.09.2024 e tutje, ankuesi ka respektuar orarin e punë duke bërë regjistrim të rregullt të vijueshmërisë në punë.

Referuar faktit të Komisionit Disiplinor së përsëritja e shkeljeve të lehta dy ose më shumë herë përbën shkelje të rëndë të punës, Kolegji i Këshillit vlerëson së një konstatim i tillë vie në shprehje vetëm kur është shqiptuar masa disiplinor për shkelje të lehtë dy ose më shumë herë, e që në rastin konkret Kolegji nuk verën ndonjë akt mbi bazën e të cilit ankuesit i jenë shqiptuar masa disiplinore për mosrespektim të orarit të punës sipas nenit 56 paragrafi 3.3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, gjegjëshit emailat e datës 20.09.2023 dhe 27.09.2024 kanë qenë kërkesa dhe njoftime, e jo akt individual, pasi që përgjegjësia disiplinore është individuale.

Po ashtu, lidhur me shkeljen mos përmbushja e detyrave të punës; neglizhencë e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; dhe mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës, Komisioni Disiplinor me asnjë prove nuk ka vërtetuar se cilat kanë qenë veprimet apo mosveprimet e ankuesit që paraqesin mos përmbushje, neglizhencë apo mos respektin të afateve në përmbushje të detyrave të punës, rrjedhimisht, Komisioni Disiplinor jep konstatime të përgjithësuar pa argumentim të fakteve relevante.

Andaj, bazuar në rrethanat dhe konstatimet si më lartë, Kolegji në mbështetje të nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, aprovoj pjesërisht si të bazuar ankesën e ankuesit, ashtu që aprovoj pretendimet për shkelje materiale ndërsa refuzoj ankesën për shkele procedurale, duke anuluar Vendimin kontestuar pasi si edhe u theksua me lartë Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të vërtetoj përgjegjësinë disiplinore te ankuesit lidhur me shkeljet që i jenë ven në barrë nga ky organ, kështu që, një vendim i nxjerr në

kundërshtim më dispozitat materiale është vendim i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1.5 të LPAA-së, dhe si i tillë nuk prodhojë pasoja juridike.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë—Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.176/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat Hajzer Salihu;
- Organit të punësimit: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.